L I G J
Nr. 8924, datë 22.7.2002

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË KREDISË NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA) PËR MBËSHTETJEN PËR RIKONSTRUKTIMIN E SEKTORIT FINANCIAR (FSAC)"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për mbështetjen për rikonstruktimin e sektorit financiar (FSAC)".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3420, datë 7.8.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJA
E KREDISË SË ZHVILLIMIT

MARRËVESHJA e datës 26.6.2002, midis Republikës së Shqipërisë (Huamarrrësi) dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (Shoqata)

Ndërsa :(A). Shoqata ka marrë një letër të datës 23.5.2002, Letra e Politikave të Zhvillimit nga Huamarrësi, që përshkruan programin e veprimeve, objektivat dhe politikat për të arritur rregullimin strukturor të sektorit financiar të ekonomisë së Huamarrësit nga vendi i (Programit), duke deklaruar angazhimin e Huamarrësit për ekzekutimin e programit dhe duke kërkuar asistencë nga Shoqata për të mbështetur këtë Program gjatë ekzekutimit të tij dhe prandaj;

B) mbi bazën, ndër të tjera sa më sipër, Shoqata ka vendosur në mbështetje të programit t'i sigurojë një asistencë të tillë Huamarrësit, duke e kaluar kredinë sipas dy rrugëve që vijojnë:

Në bazë të sa më sipër, Palët e mësipërme bien dakord për sa më poshtë:

Neni 1
Kushtet e Përgjithshme; Përkufizime

Seksioni 1.01. "Kushtet e Përgjithshme të Marrëveshjeve të Kredisë së Zhvillimit" të Shoqatës të datës 1 janar 1985 (siç janë ndryshuar deri më 6 tetor 1999) me modifikimet e mëposhtme (Kushtet e Përgjithshme) përbëjnë një pjesë të pandarë të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 2.0. paragrafi 12 modifikohet:

"Projekt" nënkupton programin e referuar në hyrje të MKZH-së, në mbështetje të të cilit jepet kredia.

Seksioni 4.01. modifikohet:

“Përveç kur Huamarrësi dhe Shoqata bien dakord ndryshe, tërheqjet nga Llogaria e Kredisë, do të bëhen në monedhën e llogarisë të specifikuar në seksionin 2.02. të MKZH-së.

Seksioni 5.01. modifikohet:

“Huamarrësi do të ketë të drejtë të tërheqë shumat e kredisë nga Llogaria e Kredisë në përputhje me dispozitat e MKZH-së dhe këto Kushte të Përgjithshme”.

Fjala e fundit e seksionit 5.03. hiqet.

Seksioni 9.06. ndryshohet si më poshtë:

“c) Jo më vonë se 6 muaj pas datës së mbylljes ose datë tjetër që do të bihet dakord për këtë qëllim midis Palëve, Huamarrësi do të përgatisë dhe do t’i dorëzojë Shoqatës një raport, me qëllim dhe detaje të tilla ashtu siç Shoqata, në mënyrë të arsyeshme, do ta kërkojë për ekzekutimin e programit, referuar në hyrjen e Marrëveshjes, performancën e Huamarrësit dhe Shoqatës dhe detyrimet reciproke të tyre nën MKZH-në dhe përmbushjen e qëllimeve të kredisë”; dhe

Seksioni 9.04. hiqet dhe seksionet 9.05,9.06.) (të ndryshuara sa më sipër 9.07., 9.08., numërohen respektivisht seksionet 9.04, 9.05, 9.06, 9.07).

Seksioni 9.02. Vetëm në ato raste ku kërkohet ndryshe nga konteksti, aktet e ndryshme të përcaktuara në Kushtet e Përgjithshme dhe në Hyrjen e kësaj Marrëveshjeje kanë kuptimet përkatëse të përcaktuara dhe termat shtesë të mëposhtëm kanë kuptimin që vijon:

(a) “ATK” do të thotë Agjencia e Trajtimit të Kredive” të Huamarrësit.

(b) “Llogaria e Kredisë” nënkupton llogarinë së cilës i referohet në seksionin 2.02. dhe të kësaj Marrëveshjeje.

(c) “INSTAT” nënkupton Institutin e Statistikave (Programin Institucional të Zhvillimit) të Huamarrësit, aprovuar më 30 prill 2002 nga Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë së Huamarrësit, përkatësisht duke ndërtuar një program për përmirësimin në forcim të legjislacionit financiar të siguruar; dhe

(d) “PMZH” do të thotë Plani i Mbikëqyrjes së Zhvillimit, i përshtatur nga Banka e Shqipërisë e Huamarrësit më 13 mars 2002, duke nxjerrë në pah strategjinë e tij afatgjatë dhe programin e zhvillimit institutcional për mbikëqyrjen e bankave.

Neni 2

Kredia

Seksioni 2.01. Shoqata bie dakord t’i huajë Huamarrësit, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara apo të referuara në Marrëveshjen e Kredisë së Zhvillimit një shumë në monedha të ndryshme të barabartë me SDR 12.000.000.

Seksioni 2.02. (a) Sipas dispozitave të paragrafëve (b) (c) dhe (d) të këtij seksioni, Huamarrësi do të autorizohet të tërheqë fondet nga Llogaria e Kredisë në mbështetje të programit.

Huamarrësi do të hapë para se t’i dorëzojë Shoqatës kërkesën e parë për tërheqje nga Llogaria e Kredisë dhe më pas do të ruajë në bankën e tij qendrore një depozitë në USD në llogari në afatet dhe kushtet e kënaqshme për Shoqatën. Të gjitha tërheqjet nga llogaria e kredisë do të depozitohen nga Shoqata në Llogarinë e Depozitës.

Humarrësi merr përsipër që shuma e kredisë nuk do të përdoret për të financuar shpenzimet e përjashtura të parapërcaktuara në skedulin 1 të kësaj Marrëveshjeje. Nëse Shoqata do të ketë vendosur ndonjëherë që shumat e kredisë janë përdorur për këto qëllime që janë të përjashtuara. Huamarrësi, menjëherë, sapo të marrë njoftim nga Shoqata:

(i) do të depozitojë në Llogarinë e Depozitës shumën e barabartë me këtë pagesë; ose (ii) do të rimbursojë Shoqatën dhe kjo shumë do të quhet anulim.

Nuk do të bëhen tërheqje nga Llogaria e Kredisë pas grumbullimit të shumës të të ardhurave të kredisë të tërhequra nga Llogaria e Kredisë deri sa të jenë arritur ekuivalencat prej 6,000,000 SDR, vetëm në rastet kur Shoqata do të kënaqet pas një shkëmbimi pikëpamjesh të parashikuara në seksionin 3.01. të kësaj Marrëveshjeje bazuar në evidencat e kënaqshme të Shoqatës:

- me progresin e arritur nga Huamarrësi në përmbushjen e programit, që kuadri i politikës makroekonomike të Huamarrësit të jetë i kënaqshëm, ashtu siç është matur në bazë të treguesve për të cilët është rënë dakord midis Huamarrësit dhe Shoqatës; dhe
- që veprimet e përshkruara në skedulin 2 të kësaj Marrëveshjeje të jenë pranuar nga Shoqata.

Në qoftë se është bërë shkëmbimi i pikëpamjeve, Shoqata nuk është shumë e kënaqur. Shoqata mund të lajmërojë Humarrësin për këtë pasojë dhe në rast se brenda 90 ditëve pas një njoftimi të tillë Huamarrësi nuk do të ndërmarrë hapat e kënaqshëm për Shoqatën sipas (i), (ii), (iii), të përcaktuara më sipër, atëherë Shoqata mund duke vënë në dijeni Huamarrësin, të anulojë shumën e patërhequr të kredisë ose çdo pjesë të saj.

Seksioni 2.03. Data e mbylljes do të jetë 31 mars 2004 apo ndonjë datë e mëvonshme që do të përcaktohet nga Shoqata. Shoqata do të njoftojë menjëherë Huamarrësin për këtë datë të mëvonshme.

Seksioni 2.04. (a) Huamarrësi do t'i paguajë Shoqatës një komision angazhimi mbi shumën kryesore të Kredisë që nuk është tërhequr herë pas here në një përqindje që do të përcaktohet nga Shoqata më datë 30 qershor të çdo viti, por që nuk duhet të kalojë gjysëm për qind të (1 e 1%) për çdo vit.

(b) Komisioni i angazhimit do të rritet: (i) pas gjashtëdhjetë ditëve nga data e kësaj Marrëveshjeje (data e interesit) deri në datat respektive në të cilat do të tërhiqen ose anulohen nga Huamarrësi shumat nga Llogaria e Kredisë; dhe (ii) në shumën e caktuar në 30 qershor menjëherë përpara datës së interesit dhe me shuma të tjera siç mund të caktohen herë pas herë në bazë të paragrafit (a) më sipër. Shuma e caktuar më datë 30 qershor të çdo viti do të zbatohet që nga data tjetër e atij viti, datë kjo e përcaktuar në seksionin 2.06. të kësaj Marrëveshjeje.

(c) Komisioni i angazhimit do të paguhet: (i) në vende të tilla që kërkon Shoqata brenda arsyes; (ii) pa kufizime të çdo lloji të vendosura në territorin e Huamarrësit; dhe (iii) në monedhën e specifikuar në këtë Marrëveshje për qëllimet e Seksionit 4.02. të Kushteve të Përgjithshme apo në ndonjë monedhë apo monedha të tjera të përshtatshme që mund të caktohen ose përzgjidhen herë pas here në bazë të dispozitave të atij seksioni.

Seksioni 2.05. Huamarrësi duhet t'i paguajë Shoqatës një tarifë shërbimi prej tre të katërtave të një për qind (3-4%) në vit mbi shumën principale të Kredisë të tërhequr dhe të papaguar herë pas here.

Seksioni 2.06. Komisioni i angazhimit dhe ai i shërbimit do të jenë të pagueshme çdo gjashtë muaj më 15 prill dhe 15 tetor të çdo viti.

Seksioni 2.07. (a) Në bazë të paragrafëve (b) (c) dhe (d) më poshtë, Huamarrësi do të paguajë shumën principale të Kredisë me këste gjashtëmujore të pagueshme në çdo 15 prill dhe 15 tetor, duke filluar nga 15 tetor 2012 dhe duke përfunduar në 15 prill 2042. Çdo kësti, duke përfshirë kështin e pagueshëm në 15 prill 2022, do të jetë një për qind (1%) e kësaj shume principale dhe çdo këst i mëvonshëm do të jetë dy për qind (2%) e kësaj shume principale dhe çdo këst i mëvonshëm do të jetë dy për qind (2%) i kësaj shume principale.

(b) Kur: (i) prodhimi i përgjithshëm kombëtar për frymë (GNP-ja) e Huamarrësit, siç është vendosur nga Shoqata, do të ketë kaluar për tre vjet rresht një pas një nivelin e përcaktuar për vit nga Shoqata për të përcaktuar mundësinë për të përfituar nga burimet e Shoqatës; dhe (ii) Banka do ta konsiderojë Huamarrësin të vlefshëm për t'i dhënë kredi, Shoqata mundet që, pas rishikimit dhe aprovimit nga drejtorët ekzekutive të Shoqatës dhe pas një konsiderimi të tillë nga ana e Shoqatës për zhvillimin e ekonomisë së Huamarrësit, të modifikojë ripagesën e kësteve në bazë të paragrafit (a) më sipër:

(A) duke i kërkuar Huamarrësit të shlyejë dyfishin e shumës të secilit prej këtyre kësteve që nuk janë bërë ende për t'u paguar deri kur të paguhet shuma principale e Kreditit; dhe

(B) duke i kërkuar Huamarrësit të fillojë pagesën e shumës principale të Kredisë që nga data e parë e pagesës gjysëmvjetore, për të cilën bëhet fjalë në paragrafin (a) më sipër, pas gjashtë apo më shumë muajsh pas datës në të cilën Shoqata njofton Huamarrësin që ngjarjet e përcaktuara në paragrafin (b) kanë ndodhur, duke pasur parasysh që do të ketë një periudhë faljeje prej një minimumi prej pesë vjetësh mbi këtë shlyerje të principalit.

(c) Nëse kërkohet nga Huamarrësi, Shoqata mund të rishikojë modifikimet e referuara në paragrafin (b) më sipër që të përfshijnë disa ose të gjitha rritjet në shumat e kësteve të tilla, pagesën e interesit në një tarifë vjetore të rënë dakord me Shoqatën mbi shumën principale të Kredisë të tërhequr herë pas here, duke pasur parasysh që, në bazë të gjykimit të Shoqatës, një rishikim i tillë nuk do të ndryshojë elementin e grantit që është marrë në bazë të modifikimit të mësipërm të shlyerjes.

(d) Nëse në ndonjë moment pas modifikimeve të termave, në bazë të paragrafit (b) më sipër, Shoqata vendos që kushti ekonomik i Huamarrësit është përkeqësuar në mënyrë të ndjeshme, në rast se kërkohet nga Huamarrësi, Shoqata mundet të modifikojë më tej termat e pagesës për të qenë

konform skedulit të kësteve, siç paraqitet në paragrafin (a) më sipër.

Seksioni 20.8. Monedha e Shteteve të Bashkuara të Amerikës specifikohet për qëllimet e Seksionit 4.02. të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 3
Zbatimi i Projektit në veçanti

Seksioni 3.01 (a) Huamarrësi dhe Shoqata duhet që kohë pas kohe me kërkesë të secilës Palë të shkëmbejnë mendimet mbi zhvillimin e arritur në përmbushjen e programit dhe veprimeve të specifikuara në skedulin 2 të kësaj Marrëveshjeje. Huamarrësi dhe Shoqata do të kërkojnë nga secila Palë të këmbejnë mendime për progresin e arritur në zbatimin e programit herë pas here.

Përpara këmbimit të tillë të mendimeve, Huamarrësi do t'i dorëzojë Shoqatës për rishikim dhe koment një raport mbi progresin e arritur në kryerjen e programit me detajet që do të kërkojë IDA.

Pa u kufizuar në dispozitën e paragrafit (a) të këtij seksioni, Huamarrësi do të këmbejë mendime me Shoqatën për ndonjë veprim të propozuar pas disbursimit të kredisë që do të kishte efekt negativ në program ose ndonjë veprim që mund të merret në kuadrin e tij, përfshirë ndonjë veprim të specifikuar në skedulin 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.02. Me kërkesë të Shoqatës, Huamarrësi do të thotë:

- të ketë të audituar Llogarinë e Depozitës, në përputhje me parimet e përshtatshme të zbatuara të auditimit, me auditorë të pavarur, të pranuar nga Shoqata;
- t'i dorëzojë Shoqatës sa më parë të jetë e mundur për një auditim të tillë, jo më vonë se 4 muaj nga data e kërkesës së këtij auditi, një kopje të certifikuar të auditit në fjalë nga auditorët e përmendur më lart, në mënyrë të arsyeshme dhe me detajet që ajo e kërkon;
- t'i dorëzojë Shoqatës informacion tjetër të tillë lidhur me Llogarinë e Depozitës, siç kërkohet nga Shoqata.

Neni 4
Ngjarje shtesë për pezullimin

Seksioni 4.01. Për qëllime të seksionit 6.02. (1) të Kushteve të Përgjithshme, ngjarja e mëposhtme do të konsiderohet e tillë kur është krijuar një situatë e tillë që e bën të pamundur që programi ose një pjesë e konsiderueshme e tij të kryhet.

Neni 5
Përfundimi

Seksioni 5.01. Data nëntëdhjetë (90) ditë pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje është specifikuar këtu më poshtë për qëllimet e seksionit 12.04. të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 6
Përfaqësuesi i Huamarrësit; Adresat

Seksioni 6.01 Ministri i Financave i Huamarrësit është caktuar si përfaqësues i Huamarrësit për qëllimet e seksionit 11.03 të Kushteve të Përgjithshme.

Seksioni 6.02. Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllimet e seksionit 11.01. të Kushteve të Përgjithshme.

Për Huamarrësin:
Ministria e Financave, Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë
Shqipëri
Faks 355 42 284 94
Për Shoqatën:
International Development Association
1818 H Street N.W.
Washington. D.C. 20433

United States of America
Adresa kabellTeleks:
INDEVAS4248423 (MCI) ose
Washington D.C.61145 (MCI)
Faks: (202) 477 -6391

Në prani të dëshmitarëve, Palët e mësipërme, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar, kanë firmosur në emrat e tyre përkatës në Distriktin e Kolumbias në Shtetet e Bashkuara të Amerikës sipas ditës dhe vitit që është shkruar më sipër.

SHQIPËRIA

ngaPërfaqësuesi i autorizuar

SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM
nga Zëvendëspresident Rajonal
Europa dhe Azia Qendrore

SKEDULI I
SHPENZIME TË PËRJASHTUARA

Për qëllime të Seksionit 2.02. të kësaj Marrëveshjeje, Kredia nuk do të përdoret për të financuar shpenzimet e mëposhtme:

- shpenzime të monedhës së Huamarrësit ose për mallra dhe shërbime të ofruara në territorin e Huamarrësit;

- shpenzime për mallra e shërbime me kontratë me ndonjë institucion financiar ndërkombëtar ose kombëtar ose agjenci përveç Bankës ose Shoqatës, të cilat kanë rënë dakord të financojnë ose të cilat Banka ose Shoqata kanë rënë dakord të financojnë me një kredi tjetër ose hua;

- shpenzime për mallra të grupeve dhe nëngrupeve të klasifikimit standard të tregtisë ndërkombëtare, publikuar nga Kombet e Bashkuara në dokumentet statistikore, ose grupe apo nëngrupe që më vonë do të rishikohen sipas SITC, siç janë caktuar Huamarrësit nëpërmjet njoftimit nga Shoqata.

Pije alkoolike
Duhan i papërpunuar
Duhan i përpunuar
Materiale radioaktive
Perla dhe gurë të çmuar e gjysëm të çmuar të punuar dhe të papunuar
Reaktorë bërthamorë dhe pjesë të tyre; elemente furnizimi të parrezatuar për reaktorë bërthamorë
Makineri të përpunimit të duhanit
Buzhuteri ari, platini, argjendi: (përveç orëve) dhe bizhuteri të përpunuara nga argjendarët
Arjomonetar (duke përjashtuar mineralet ku gjendet ar si dhe koncentrate)
Shpenzime militare ose para-militare ose për konsum luksi

- shpenzime për mallra të rrezikshme për ambientin që do të thotë ato mallra prodhimi, përdorimi apo importi i të cilave konsiderohet i ndaluar nga ligjet e Huamarrësit dhe marrëveshjet ndërkombëtare;

- shpenzime: (a) në territoret e ndonjë vendi që nuk është anëtar i Bankës ose mallra e shërbime të prokuruara në këto territore; ose (b) për llogari të çdo personi ose njësie tregtare ose për ndonjë import të ndonjë malli, nëse kjo pagesë ose import ndalohet me vendim të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, siç shkruhet në kapitullin VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara; dhe

- shpenzime sipas ndonjë kontrate në lidhje me të cilën Shoqata ka vendosur se janë përdorur praktika korrupsioni ose mashtrimi gjatë prokurimit ose ekzekutimit të kontratës prej përfaqësuesve të Huamarrësit ose të Kredisë kur Huamarrësi nuk ka marrë masa të përshtatshme të kënaqshme për të rregulluar situatën.

SKEDULI 2
PROGRAMI I VEPRIMEVE TË CILAVE I REFEROHEMI NË SEKSIONIN 2.02 (D) TË PREAMBULËS SË KËSAJ KONTRATE

1. Huamarrësi ka nënshkruar një kontratë me investitorë strategjikë për të finalizuar shitjen e të paktën 50% plus 1 aksion të Bankës së Kursimeve të Huamarrësit.

2. Huamarrësi ka stabilizuar Agjencinë e saj të Sigurimit të Depozitave dhe ka përparuar kënaqshëm në zbatimin e programit financiar të saj.

3. Huamarrësi ka bërë progres të kënaqshëm në zbatimin e ASD-së së saj për mbikëqyrjen bankare.

4. Huamarrësi ka bërë përparim të kënaqshëm në zbatimin e IDP-së për përforcimin kundër falimentit dhe financim të sigurt.

5. Huamarrësi ka bërë progres të kënaqshëm në zbatimin e një plani strategjik biznesi për BART, përfshirë këtu edhe çlirimi nga së paku 15% e vlerës së profilit të tij.

6. Është vepruar kënaqshëm me legjislacionin e sigurimit.

7. Huamarrësi ka përcaktuar një agjenci sigurimi rregullatore me pavarësi buxhetore dhe operative.